



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-066

PËR AZIL

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për azilin,

Miraton këtë

LIGJ PËR AZIL

KREU I

Dispozitat e Përgjithshme dhe Parimet Themelore

Neni 1

Qëllimi i Ligjit

Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen, ndërprerjen, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azil-kërkuesve, azilantëve, si dhe të personave të cilëve iu është lejuar Mbrojtja Plotësuese dhe Mbrojtja e Përkohshme.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij ligji, shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

2.1 “Azil” është mbrojtja që Kosova i ofron refugjatëve. Azili përfshin të drejtën për vendqëndrim në Republikën e Kosovës si dhe të drejtat tjera që parashihen me këtë ligj.

2.2 “Azil-kërkues” është i huaji, i cili e ka parashtruar kërkesën e tij ose të saj për azil ose Mbrojtje Plotësuese. Ai / ajo konsiderohen të tillë që nga momenti i parashtrimit të kërkesës për azil deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2.3 “Azilant” është i huaji, të cilit i është lejuar statusi i azilit në Republikën e Kosovës.

2.4 “I huaj”, sipas këtij ligji, ju referohet të gjithë personave brenda Republikës së Kosovës të cilët nuk janë shtetas të Kosovës.

2.5 “Kërkesa për azil” është kërkesa e parashtruar me gojë ose me shkrim nëpërmjet të cilës një i huaj kërkon mbrojtjen, qoftë azilin, apo Mbrojtjen Plotësuese, në pajtim me nenin 4 të këtij ligji.

2.6 “Organi kompetent” është organ brenda strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përgjegjës për marrjen e vendimeve mbi kërkesat për azil, mbrojtjen plotësuese dhe kërkesat e ndërlidhura si dhe vendimet për ndërprerjen e Azilit dhe të mbrojtjes plotësuese.

2.7 “Mbrojtja Plotësuese” është mbrojtja e lejuar jashtë fushëveprimit të përkufizimit për refugjatë, për një të huaj, i cili nuk mund të përcaktohet si refugjat, por për të cilin ekziston një mundësi serioze për të besuar se ky person, nëse kthehet në vendin e tij ose të saj të prejardhjes, ose në rast të personit pa shtetësi, në vendbanimin e tij / saj të mëparshëm, do të përballet me rrezik serioz siç përcaktohet në nenin 2.7.1 të këtij ligji, dhe i cili, për shkak të rrezikut të tillë, nuk është në gjendje të kthehet në atë vend.

2.7.1 Rrezik serioz është:

(i) Shqiptimi i dënimit me vdekje ose kërcënim për ekzekutim;

(ii) Tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues i personit;

(iii) Kur cilido person i cili është i shtrënguar të braktisë vendin e tij e të kërkojë strehim në një vend tjetër, për shkak të agresionit të jashtëm, pushtimit, dominimit të huaj ose ngjarjeve që seriozisht e çrregullojnë rendin publik në cilëndo pjesë ose në tërë vendin e origjinës ose të shtetësisë.

2.8 “Refugjat” është personi i cili, për shkak të frikës së bazuar nga përndjekja, për shkak të racës, religjionit, kombësisë, përkatësisë së grupit shoqëror ose bindjes politike, është jashtë vendit të shtetësisë së tij dhe nuk është në gjendje ose për shkak të frikës së tillë, nuk ka vullnet të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi ose i cili, duke mos pasur shtetësi dhe duke qenë jashtë vendit të tij ose të saj të banimit të përhershëm nuk është në gjendje ose për shkak të frikës së tillë, nuk ka vullnet për t’u kthyer në te. Në rastin e personit, i cili ka më shumë se një shtetësi, shprehja “vendi i shtetësisë së tij” ka kuptimin e secilit vend shtetas i të cilit është dhe nuk do të konsiderohet se personit i mungon mbrojtja e vendit të shtetësisë së tij nëse ai ose ajo nuk kanë vullnet t’ia besojnë mbrojtjen e vet njërit prej vendeve shtetas / shtetase i/e të cilit është.

2.8.1 “Aktorët e përndjekjes” për qëllim të përkufizimit të kuptimit të refugjatit ose për përdorim në përcaktimin e të drejtës në Mbrojtjen Plotësuese, përfshijnë: Shtetin, partitë ose organizatat që e kontrollojnë shtetin, një pjesë substanciale të territorit të shtetit; ose aktorët jo shtetëror, nëse mund të demonstron se aktorët e sipërpërmendur nuk janë në gjendje ose nuk kanë vullnet për të siguruar mbrojtjen kundër përndjekjes ose dëmit serioz siç përkufizohet në nenin 2.7.1. të këtij Ligji.

2.9 “Vendi i origjinës” është vendi në të cilin i huaji është shtetas i tij, ose vendi në të cilin personi pa shtetësi ka pas vendqëndrimin.

2.10 “Mbrojtje e Përkohshme” është mbrojtja e cila ju lejohet të huajve në rastin e një fluksi masiv të personave që kërkojnë strehim në Republikën e Kosovës si pasojë e efekteve pa

dallim të konfliktit të armatosur dhe nga dhuna e përgjithësuar, ose personat, jeta, integriteti personal dhe liria e të cilëve është në rrezik si rezultat i shkeljes në shkallë të gjerë të të drejtave të njeriut. Mbrojtja e përkohshme mund të shfrytëzohet si një masë e përkohshme që nuk kalon dy vite, kur procedurat individuale të azilit, siç parashihet brenda këtij ligji, konsiderohen nga Ministria e Punëve të Brendshme të jenë jopraktike për shkak të vëllimit të kërkesave të mundshme për azil.

Neni 3 Mbrojtja e integritetit familjar

3.1 Në pajtim me këtë ligj, azili dhe mbrojtja plotësuese ju lejohet anëtarëve të pakontestueshëm të familjes së ngushtë të azilantit.

Neni 4 Njohja e azilit dhe e mbrojtjes plotësuese

4.1 Kosova do t'i lejon Azilin të huajit për të cilin është përcaktuar se i plotëson kriteret në përkufizimin e refugjatit siç parashihet në nenin 2.8 të këtij Ligji dhe i cili nuk mund të përjashtohet siç parashihet në nenin 5 të këtij Ligji.

4.2 Kosova i ofron mbrojtje plotësuese të huajit i cili nuk i plotëson kriteret e parapara në përkufizimin e refugjatit, por i plotëson kriteret e përcaktuara në definicionin e mbrojtjes plotësuese në nenin 2.7 të këtij Ligji. Nëse i huaji përjashtohet sipas nenit 5 të këtij Ligji, atëherë ai ose ajo nuk do të marrin mbrojtje plotësuese sipas nenit 2.7.1 iii të këtij Ligji. Nëse dhënia e mbrojtjes plotësuese bëhet në pajtim me nenin 2.7.1.i ose 2.7.1.ii të këtij Ligji atëherë bazat për përjashtim të përcaktuara në nenin 5 të këtij Ligji nuk vlejné.

4.3 Vendosja lidhur me azilin dhe mbrojtjen plotësuese, do të zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar më këtë Ligj. Së pari shqyrtohen kërkesat e për Azil.

Neni 5 Përjashtimi nga azili

5.1 Një personi nuk do t'i njihet e drejta e azilit kur ekzistojnë arsye serioze, për të konsideruar se ai / ajo:

(i) ka kryer krim kundër paqes, krim lufte ose krim kundër njerëzimit, të definuar me aktet ndërkombëtare dhe normat e tyre lidhur me krimet e tilla;

(ii) ka kryer krim të rëndë jopolitik jashtë Kosovës para ardhjes në Kosovë;

(iii) është fajtor për vepra në kundërshtim me parimet dhe objektivat e Kombeve të Bashkuara.

5.2 Azili nuk do t'iu lejohet personave të cilët tashmë gëzojnë ndihmën ose mbrojtjen e organeve dhe agjencive të Kombeve të Bashkuara, përveç mbrojtjes ose ndihmës së

Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatë. Kur një mbrojtje ose ndihmë e tillë ka pushuar për çfarëdo arsye, pa u vendosur definitivisht pozita e këtyre personave në pajtim me rezolutat relevante të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, këta persona në bazë të fakteve (ipso facto) kanë të drejtë të përfitojnë nga ky ligj.

5.3 Azili nuk do t'u lejohet personave, për të cilët të drejtat dhe detyrimet e ngjashme si shtetas të Kosovës janë të njohura nga Shteti i Kosovës.

Neni 6

Ndërprerja dhe anulimi i azilit dhe e mbrojtjes plotësuese

6.1 Azili mund të përfundojë përmes ndërprerjes së statusit nga ana e organit kompetent për personin të cilit i është dhënë azili në Republikën e Kosovës nëse:

- (i) ai / ajo vullnetarisht e kërkon përsëri mbrojtjen e vendit, shtetësinë e të cilit e posedon;
- (ii) ai / ajo, pas humbjes së shtetësisë së tij / saj, vullnetarisht e ka rifituar atë;
- (iii) ai / ajo merr shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e vendit, shtetësinë e të cilit e ka marrë;
- (iv) ai / ajo vullnetarisht është vendosur në vendin prej të cilit ai ose ajo ka ikur për shkak të frikës nga përndjekja;
- (v) ai / ajo nuk mund të vazhdoj të refuzoj mbrojtjen e vendit të shtetësisë për shkak se kushtet, në bazë të të cilave i është njohur azili, kanë pushuar të ekzistojnë;
- (vi) për personat pa shtetësi, nëse ai ose ajo është në pozitë për t'u kthyer në vendin e banimit të tij ose të saj të përhershëm, ngase kushtet që e kanë bërë të mundur njohjen e azilit kanë pushuar së ekzistuari;
- (vii) azili mund të ndërpritet kur i huaji është dashur të përjashtohet nga e drejta për statusin e tillë për arsyet e saktësuara në nenin 5 të këtij Ligji, ose për shkak të keq interpretimit ose mungesës së fakteve, duke përfshirë shfrytëzimin e dokumenteve të rrejshme, që është arsye e bazuar në përcaktimin për dhënien e azilit.

6.2 Përjashtim nga nënparagrafët 6.1 (v) dhe 6.1 (vi) të paragrafit 1 të këtij neni kemi në rastin kur personit të cilit i është dhënë azili ku ai ose ajo është në gjendje për të dëshmuar arsye bindëse, që dalin nga përndjekja e mëparshme, që refuzon mbrojtjen e vendit shtetësinë e të cilit e posedon. Kur azilanti nuk ka shtetësi, ai ose ajo është në gjendje të dëshmoj arsye bindëse që dalin nga përndjekja e mëparshme që refuzon kthimin në vendqëndrimin e tij të mëparshëm.

6.3 Ndërprerja dhe përfundimi i azilit si dhe veprimet tjera përkitazi me statusin e refugjatit sipas nenit 6 të këtij Ligji do të zbatohen në pajtim me procedurat e përcaktuara për dhënien e azilit.

6.4 Mbrojtja plotësuese sipas nenit 2.7.1(i) të këtij Ligji, mund të përfundojë me të vendim i organit kompetent kur verifikohet se i huaji nuk do t'i nënshtrohet dënimit me vdekje pas kthimit në vendin e tij / saj të origjinës ose në rast të të huajit pa shtetësi në vendin e banimit të tij të përhershëm. Në rast të përfundimit të këtij statusi, i huaji ka të drejtë të parashtrij kërkesën për shqyrtim siç parashihet me nenin 6.2 të këtij Ligji.

6.5 Mbrojtja plotësuese e dhënë sipas nenit 2.7.1.ii të këtij Ligji mund të përfundojë me vendim të organit kompetent kur verifikohet se i huaji nuk do të ballafaqohet me rrezikun e torturës, trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor e degradues pas kthimit në vendin e tij / saj të origjinës ose në rastin e të huajit pa shtetësi, në vendin e banimit të tij të përhershëm. Në rast të përfundimit të këtij statusi, i huaji i kësaj kategorie ka të drejtë të parashtoj kërkesën për shqyrtim siç parashihet me nenin 6.2 të këtij Ligji.

Neni 7

Ndalimi i kthimit ose i dëbimit me dhunë

7.1 Nuk lejohet dëbimi i detyruar apo deportimi i azil-kërkuesit, azilantit në çfarëdo mënyre në territorin ku jeta apo liria e tij / saj do të rrezikoheshin për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë shoqëror ose mendimit politik.

7.2 Përfitimet nga neni 7.1, mund të mos i njihen një refugjati, azil-kërkuesi nën mbrojtje plotësuese sipas nenit 2.7.1.iii. të këtij Ligji për të cilin ekzistojnë arsye të bazuara që konsiderohen rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës, i cili, duke qenë i dënuar me aktgjykim të prerë për një vepër posaçërisht të rëndë, përbënë rrezik për popullatën e Republikës së Kosovës.

7.3 Askush nuk mund të dëbojë ose të kthej një individ në çfarëdo mënyre në territorin kur ekzistojnë arsye të bazuara për të besuar se ai/ajo do t'i nënshtroheshin dëmtimit serioz të përkufizuar në nenin 2.7.1.i. ose 2.7.1.ii. të këtij Ligji.

7.4 Organi Kompetent do t'i lejoj të huajit mundësinë që të kundërshtojë dëshminë se deportimi i tij sipas nenit 7.2 të këtij Ligji është i ligjshëm.

Neni 8

Hyrja në territorin e Republikës së Kosovës

8.1 I huaji, i cili deklaron qëllimin e tij / saj për parashtrimin e kërkesës për azil në Republikën e Kosovës, do të trajtohet si një azil-kërkues në pajtim me këtë Ligj, pra, ai/ajo do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës.

8.2 Ministria e Punëve të Brendshme në tekstin më tej: Ministria, me akte nënligjore përcakton procedurat dhe standardet për trajtimin e azil kërkuesve në pajtim me dispozitat dhe parimet e përcaktuara në Instrumentet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë direkt të zbatueshme në Republikën e Kosovës si dhe Konventën e vitit 1951 për Statusin e Refugjatëve si dhe ligjin ndërkombëtar të zbatueshëm. Aktet nënligjore përcaktojnë që Policia Kufitare t'u ofrojnë informata lidhur me procedurat për azil të huajve të cilët hyjnë në Republikën e Kosovës.

8.3 Mbrojtja e të drejtave individuale të garantuara me standardet ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatit do të përbëjnë minimumin e standardeve të mbrojtjes, të cilat duhet t'i lejohen azil-kërkuesit. Ligji në fuqi gjithmonë do të interpretohet në frymën e minimumit të lartpërmendur të standardeve të mbrojtjes.

Neni 9

Hyrja ilegale në territorin e Republikës së Kosovës

9.1 I huaji, i cili hyn ilegalisht në territorin e Republikës së Kosovës me qëllim të kërkimit të azilit, duhet t'i parashtrijë Organit Kompetent pa vonesë kërkesën për azil.

9.2 Azil-kërkuesit, nuk do të dënohen për hyrje ilegale, qoftë duke ju shmangur doganës/inspektimit të imigracionit ose përmes përdorimit të dokumenteve joadekuate dhe/ose false për të hyrë apo për të qëndruar ilegalisht në territorin e shtetit.

Neni 10

Ndihma për Azilkërkuesit

10.1 Azil-kërkuesi mund të kërkojë azil në gjuhën të cilën ai ose ajo e kupton dhe nga ai/ajo nuk kërkohet të kërkojë azil në ndonjërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

10.2 Azil-kërkuesi do të informohet për procedurën për përcaktimin dhe njohjen e azilit, për të drejtat dhe detyrimet e tij/ saj në procedurën e tillë, si dhe për të drejtën të kontaktoj Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë – UNHCR-në, (në tekstin e mëtejshëm UNHCR), dhe ndonjë Organizatë Joqeveritare- OJQ, (në tekstin e mëtejshëm OJQ), të cilat ju ofrojnë ndihmë azilkërkuesëve. .

10.3 Azilkërkuesi e ka të drejtë të zgjedh një përfaqësues ligjor, i cili do ta ndihmojë dhe përfaqësojë atë gjatë procedurës për përcaktimin e azilit, me shpenzime të azil kërkuesit.

10.4 Përfaqësuesi ligjor i azilkërkuesit si dhe përfaqësuesi i Zyrës së UNHCR-së kanë të drejtë të kontaktojnë azilkërkuesin në çdo kohë dhe në secilën fazë të procedurës për përcaktimin e azilit.

10.5 Azilkërkuesi ka të drejtë të flas me përfaqësuesin e vet ligjor ose përfaqësuesin e UNHCR-së në çdo kohë, si dhe të jetë i informuar për këtë të drejtë.

Neni 11

Kufizimi i lëvizjes

11.1 Si parim i përgjithshëm, azilkërkuesit nuk duhet të arrestohen gjatë vendosjes lidhur me kërkesën së tyre për azil. Kufizimi i lëvizjes mund të urdhërohet me vendim të Organit Kompetent.

11.2 Nëse është e domosdoshme, lëvizja e azilkërkuesit mund të kufizohet përkohësisht në situatat e mëposhtme:

- (i) me qëllim të përcaktimit të identitetit të azilkërkuesit;
- (ii) për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive;
- (iii) për arsyet e përcaktuara në nenin 28 të këtij Ligji.

(iv) në rastin e të huajit për të cilin ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se paraqet rrezik për sigurinë kombëtare ose për rendin publik.

11.3 Lëvizja mund të kufizohet në përputhje me nenin 11.2 të këtij Ligji :

- (i) me ndalimin e lëvizjes jashtë Qendrës së Azilit;
- (ii) me ndalimit të lëvizjes jashtë zonës së caktuar gjeografike;
- (iii) me ndalimin për të lëvizur nga adresa e caktuar për jo më shumë se 12 orë çdo ditë.
- (iv) në rastin e të huajit, për të cilin ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se paraqet rrezik për sigurinë kombëtare ose rrezik për komunitetin, i huaji mund edhe të paraburgoset në përputhje me standardet ndërkombëtare.

11.4 Kufizimi i lëvizjes sipas nenit 11.2 të këtij ligji mund të urdhërohet me vendim të Ministrisë. Urdhëri i cili kufizon lëvizjen e azil kërkuesve mund të jetë në fuqi derisa nuk pushojnë arsyet për të, por në asnjë rast më gjatë se një muaj. Nëse arsyet për kufizim ekzistojnë pas kësaj periudhe, kufizimet mund të zgjaten për një periudhë shtesë prej një muaji. Urdhëri i cili kufizon lëvizjen e azil kërkuesit për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektuese do të jetë në fuqi deri sa të kaloj rreziku nga infeksioni.

11.5 Kundër vendimit të Ministrisë lidhur me kufizimin e lëvizjes azil-kërkuesi mund të parashtrijë ankesë, në çdo kohë, në gjykatën kompetente.

Neni 12

Bashkëpunimi i organeve shtetërore me Zyrën e UNHCR-së

12.1 Sa i përket azilkërkuesëve, azilantëve dhe personave të cilëve u është lejuar Mbrojtja Shtesë dhe e Përkohshme, organet shtetërore të Kosovës ndihmojnë Zyrën e UNHCR-së për kryerjen e detyrave të saj, në veçanti lidhur me zbatimin e Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatit dhe Instrumentet e tjera Ndërkombëtare që merren me refugjatët si dhe Konventës së vitit 1954 lidhur me Statusin e Personave pa shtetësi.

12.2 Organet kompetente të Republikës së Kosovës, me kërkesën e UNHCR-së, dërgojnë informatat dhe të dhëna statistikore për:

- (i) gjendjen e azilkërkuesve, azilantëve, të personave me Mbrojtje Plotesuese si dhe personave që kanë Mbrojtjen e Përkohshme;
- (ii) zbatimin e Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatit dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura ndërkombëtare për refugjatët;
- (iii) ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi ose ende në përgatitje e sipër lidhur me Azilin, Shtetësinë, Statusin Civil dhe Regjistrimin Civil.

Neni 13

Mbrojtja e të dhënave

13.1 Të dhënat personale të mbledhura gjatë procedurës së azilit nga Organet Kompetente dhe organet e tjera shtetërore mbrohen në pajtim me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

13.2 Të gjitha deklaratat, dëshmitë dhe të dhënat që i parashtrohen Organit Kompetent nga azilkërkuesi gjatë procedurës së azilit konsiderohen konfidenciale.

13.3 Informatat e marra gjatë procedurës së azilit nuk do t'i komunikohen vendit të origjinës së azilkërkuesit, azilantit ose personit të cilit i është dhënë Mbrojtja e Pëkohshme apo Mbrojtja Plotesuese, përveç siç është paraparë në nenin 67 të këtij Ligji.

KREU II

Neni 14

Zbatimi i Ligjit mbi Procedurën Administrative

14.1 Nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj, procedura e azilit do të jetë në përputhje me Ligjin për Procedurën Administrative.

Neni 15

Organet Përgjegjëse për Azil

15.1 Organi përgjegjës për vendosje në shkallën e parë lidhur me kërkesën për azil përbëhet nga zyrtarë të Departamentit për Kufij, Azil dhe Migracion (në tekstin e mëtejshmë: DKAM).

15.2 Ankesa kundër vendimit të organit të shallës së parë, vendoset nga Komisioni Kombëtar për Refugjatë, (në tekstin e mëtejshmë: Komisioni).

15.3 Kundër vendimit përfundimtar të Komisionit, mund të kërkohej shqyrtim gjyqësor në pajtim me procedurat e përcaktuara me ligj lidhur me shqyrtimin gjyqësor të vendimeve administrative.

Neni 16

Parashtrim i kërkesës për azil

16.1 Kërkesa për azil nga i huaji mund të bëhet me gojë ose në formën e shkruar gjatë kontrollit në pikën e kalimit kufitar, në çdo stacion policor dhe në zyrat e DKAM.

16.2 Regjistrimi i azilkërkuesit bëhet me plotësimin e pyetësorit për regjistrim.

16.3 Policia njofton DKAM-në për çfarëdo kërkesë për azil dhe DKAM-ja cakton procedurat për të njoftuar në mënyrë adekuate UNHCR-në lidhur me pranimin e kërkesës për Azil.

16.4 Në procedurën e regjistrimit, azil-kërkuesit i sigurohet shërbimi i përkthimit në gjuhën e tij amtare ose në gjuhën të cilën ai ose ajo e kupton.

16.5 Organi kompetent i cili bën regjistrimin, është i obliguar të marrë shenjat e gishtërinjve dhe të bëjë një fotografim të azil-kërkuesit.

16.6 Në rastet kur regjistrimi i azil-kërkuesit bëhet në pikën e kalimit kufitar apo në stacionin policor, të gjithë regjistrat dhe formularët i dërgohen DKAM-it, për zhvillimin e procedurës së azilit.

16.7 Formulari i regjistrimit do të nënshkruhet nga azil kërkuesi për të konfirmuar saktësinë pasi që të jetë përkthyer në gjuhën të cilën ai / ajo e kupton.

16.8 Ministria nxjerr akte nënligjore për të specifikuar format dhe procedurat që do të përdoren lidhur me regjistrimin.

Neni 17

Parimet e procedurës së Azilit

17.1 Procedura e azilit fillon kur i huaji paraqet kërkesën për mbrojtje.

17.2 Organi Kompetent i mundëson azil-kërkuesit të paraqesë, shpjegojë dhe dëshmojë të gjitha faktet dhe rrethanat të cilat janë relevante për kërkesën e tij/ saj për azil.

17.3 Azil-kërkuesi duhet plotësisht të bashkëpunojë në mënyrë aktive me Organin Kompetent gjatë procedurës. Azil-kërkuesi do të paraqesë dhe të shpjegojë të gjitha faktet dhe rrethanat për të cilat është në dijeni me qëllim që ta ndihmojë Organin Kompetent në shqyrtimin e dëshmive të cilat i ka në dispozicion azil kërkuesi. Ai/ ajo do të paraqes të gjitha dokumentet përkatëse në posedim të tij / saj që mund të jenë relevante për përcaktimin e azilit.

17.4 Organi Kompetent shqyrton kontekstin e informacionit lidhur me situatën aktuale në vendin prej të cilit ka ikur personi dhe përpiqet të verifikojë faktet dhe rrethanat e ndërlidhura me azil-kërkuesin në lidhje me çfarëdo dëshmie të ofruar nga ai/ajo. Organi Kompetent mund të marrë në konsideratë dëshmi shtesë që ka dispozicion e me qëllim të vendosjes për azilin.

17.5 Vendimet e Organit Kompetent për të njohur ose refuzuar azilin nuk merren vetëm në bazë të dokumenteve formale dhe dëshmive tjera të ngjashme. Vendimi merret duke u bazuar në vlerësimin e të gjitha dëshmive që janë në dispozicion, përfshirë edhe deklaratat e azil kërkuesit.

17.6 Gjatë procedurës së azilit, Organi Kompetent do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar që procedura të mos jetë e pafavorshme dhe për aq sa është e mundshme dhe kur të jetë e nevojshme, azil-kërkuesi të ndihmohet në paraqitjen e kërkesës tij/saj. Zyrtarët përgjegjës për intervistimin e azil-kërkuesit janë përgjegjës të parandalojnë që mungesa e dijes dhe e përvojës së azil-kërkuesit të mos i dëmtojë të drejtat e tij.

Neni 18

E drejta për përkthyes gjatë procedurës së azilit

18.1 Azilkërkuesi ka të drejtë për të kuptuar dhe marrë pjesë në procedurë në gjuhën të cilën ai ose ajo e kupton. Nëse azilkërkuesi nuk e kupton gjuhën zyrtare të procedurës, atij/ asaj do t'i sigurohet përkthyesi gjatë tërë procedurës.

18.2 Përkthyesi i azilkërkuesit duhet të jetë i licencuar nga Gjykata. Nëse kjo nuk është e mundshme, përkthimi duhet të bëhet nga një person i besueshëm i aftë për të përkthyer në gjuhën të cilën azilkërkuesi e kupton. Përkthyesi do të pajtohet për kushtet e fshehtësisë, siç parashihen me këtë ligj. Gjithashtu, në masën e mundshme, zgjedhja e përkthyesit duhet të ketë parasysh gjininë dhe rrethanat e azil-kërkuesit.

18.3 Përkthyesi e gëzon të drejtën e kompensimit, që paguhet në pajtim me tarifat e përcaktuara nga Organi Kompetent.

18.4 Azilkërkuesi do t'ia paraqes Organit Kompetent të gjitha dokumentet përkatëse në origjinal dhe kopje që i ka në dispozicion për shqyrtim gjatë procedurës së përcaktimit të azilit. Organi Kompetent do të sigurojë përkthimin e këtyre dokumenteve në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera zyrtare në Kosovë, nëse vlerësohet se është e domosdoshme për sjelljen e vendimit lidhur me kërkesën për azil.

Neni 19

Femrat azilkërkuese

19.1 Pas kërkesës, femrat azilkërkuese kanë të drejtë që procedurën e azilit ta zhvillojë zyrtarja, në pajtim me mundësitë.

19.2 Femra azilkërkuese do të ketë të drejtë të ketë një përkthyes femër, nëse është e mundshme.

Neni 20

I mituri i pashoqëruar

20.1 I mitur i pashoqëruar është i huaji i cili është nën moshën 18 vjeçare dhe i cili nuk është i shoqëruar nga prindërit e tij ose të saj ose personi tjetër përgjegjës sipas ligjit.

20.2 Para fillimit të procedurës së azilit, duhet të caktohet kujdestari për të miturin e pashoqëruar në pajtim me ligjet në fuqi lidhur me caktimin e kujdestarëve për të miturit. Përkundër përcaktimit të kujdestarit, fëmija, deri në masën e mundshme, duhet të jetë në gjendje për t'ia paraqes pikëpamjet e tij ose të saj të ditura para Organit Kompetent ose ndonjë organi tjetër i cili shqyrton kërkesën për azil. Të gjithë zyrtarët qeveritar duhet të kenë parasysh moshën e të miturit si dhe aftësitë e tij/saj mendore kur vlerësojnë dhe vendosin për rastin.

20.3 Kërkesa për azil e parashtruar nga një i mitur i pashoqëruar ka prioritet në raport me kërkesat tjera dhe do të zgjidhet në periudhën më të shkurtër të mundshme.

20.4 Organi Kompetent e vërteton identitetin e të miturit dhe do të verifikon nëse ai ose ajo është i pashoqëruar. Ky përcaktim do të bëhet në afatin më të shkurtër të mundshëm.

20.5 Interesat vitale të fëmijës do të kenë konsideratën parësore në të gjitha vendimet lidhur me kujdestarinë dhe kujdesin e të miturit të pashoqëruar gjatë tërë procedurës për azil.

20.6 Qeveria do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të gjetur prindërit ose të afërmit e tjerë të ngushtë të të miturit të pashoqëruar në bashkëpunim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Neni 21

Azil-kërkuesit me të meta mentale

Për azil-kërkuesit me aftësi të zvogëluara mentale duhet të caktohet një përfaqësues ligjor para fillimit të procedurës.

Neni 22

Njoftimi i Zyrës së UNHCR-së për fillimin e procedurës

22.1 Organi Kompetent do të njoftojë, pa vonesë UNHCR-në mbi fillimin e procedurës për azil.

22.2 Zyra e UNHCR-së ka të drejtë të kërkojë informacion lidhur me cilindo azil-kërkues si dhe kopjet e materialeve dhe dokumenteve të cilat mbahen në dosjet e Qeverisë.

22.3 Zyra e UNHCR-së ka të drejtë, në të gjitha fazat e procedurës, të kontaktoj me cilindo azil-kërkues, azilant si dhe me ata të cilëve iu është dhënë Mbrojtja Plotësuese dhe Mbrojtja e Përkohshme.

Neni 23

Pjesëmarrja e palëve të treta në procedurën e azilit

23.1 Procedura e Azilit nuk do të jetë e hapur për publikun.

23.2 Individët e mëposhtëm mund të jenë prezentë në procedurën e azilit:

- (i) përfaqësuesi ligjor;
- (ii) kujdestari ligjor për të miturin e pashoqëruar ;
- (iii) përfaqësuesi i UNHCR-së;
- (iv) përkthyesi.

23.3 Organi kompetent i njofton për datën dhe vendin e dëgjimit të gjithë personat që kanë të drejtë të jenë prezent në dëgjim, në kohë të duhur.

Neni 24

Intervista e Azil-kërkuesit

24.1 Organi Kompetent do të intervistojë secilin azil-kërkues para se t'ia jep azilin. Nëse është e domosdoshme, azil-kërkuesi mund të intervistohet disa herë.

24.2 Përmes intervistës, Organi Kompetent do të përpiqet të përcaktojë në veçanti, por nuk kufizohet me:

- (i) identitetin e azil-kërkuesit dhe të anëtarëve të tjerë të familjes që e shoqërojnë atë;
- (ii) bazat e kërkesës së tij ose të saj për azil;
- (iii) mënyrën e hyrjes në Kosovë dhe faktin nëse ai ose ajo kanë parashtruar kërkesën për azil në ndonjë shtet tjetër.

24.3 Azil-kërkuesi do të deklarojë të gjitha faktet dhe rrethanat që mbështesin kërkesën e tij /saj për azil. Në mënyrë specifike azil kërkuesi do të deklaroj frikën e tij të bazuar nga përndjekja dhe arsyet pse nuk duhet të depërtohet me forcë në vendin e tij apo në vendin ku ka pasur vendqëndrimin. Azil-kërkuesi do t'i dorëzojë Organit Kompetent të gjitha dëshmitë që ka në dispozicion për të mbështetur kërkesën e parashtruar të tij/saj.

24.4 Organi Kompetent i ofron azil-kërkuesit kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për intervistën e tij ose të saj dhe kohë të mjaftueshme për të kërkuar mbështetje nga përfaqësuesi i tij ose i saj ligjor.

Neni 25

Vërtetimi i fakteve relevante

25.1 Organi kompetent, sipas detyrës zyrtare, vërteton të gjitha faktet relevante për marrjen e vendimit. Organi kompetent, nëse e konsideron të domosdoshme, do të zhvillojë dëgjime plotësuese të azil-kërkuesit, të shqyrtojë provat e nxjerra dhe nëse ka nevojë të kërkojë edhe prova të tjera.

25.2 Në rastet kur zyrtari i autorizuar, i cili e udhëheq procedurën e azilit, ka nevojë për mendimin e ekspertit për të përcaktuar një fakt material në marrjen e vendimit lidhur me një kërkesë të azilit, Organi Kompetent është i autorizuar të konsultojë një ekspert të asaj fushe. Eksperti udhëzohet lidhur me fshehtësinë e procedurës dhe do të pajtohet me kushtet e fshehtësisë, siç përcaktohet me këtë Ligj.

25.3 Organi Kompetent është i autorizuar të këshillohet me ekspertin në çështjet e dëshmimeve për përcaktimin e azilit sipas kërkesës së azil-kërkuesit, përfaqësuesit ligjor të tij ose të saj ose përfaqësuesit të Zyrës së UNHCR-së nëse e vlerëson se mendimi i tillë mund të jetë i rëndësishëm për të vendosur për azilin.

Neni 26
Vendimi i shkallës së parë

26.1 Organi Kompetent do të nxjerr vendimin e shkallës së parë përmes të cilit:

- (i) e njeh Azilin apo Mbrojtjen Plotësuese kur vërteton se azilkërkuesi i përmbush kriteret relevante;
- (ii) refuzon kërkesën për azil kur gjen se nuk është e bazuar dhe cakton një periudhë kohe brenda së cilës azilkërkuesi duhet të lëshojë territorin e Kosovës, sipas nenit 27 apo 28 të këtij ligji.

26.2 Pas miratimit të kërkesës për azil, Organi Kompetent do të nxjerr vendim në pajtim me këtë ligj, me të cilin i njihet azili në Republikën e Kosovës.

Neni 27
Refuzimi i kërkesës për Azil dhe Mbrojtje Plotësuese

27.1 Organi Kompetent do të refuzojë kërkesën për azil nëse azilkërkuesi nuk e plotëson përkufizimin e refugjatit dhe konstatohet të mos ketë të drejtë për këtë status në pajtim me nenin 5 të këtij ligji. Organi Kompetent do t'i refuzojë të huajit Mbrojtjen Plotësuese nëse nuk i plotëson kriteret e parashtruara për Mbrojtjen Plotësuese ose nëse konstatohet se nuk e ka të drejtën për këtë status, siç parashihet në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji.

27.2 Kur Azili dhe Mbrojtja Plotësuese refuzohen, Organi Kompetent do të jep arsyet për vendimin me shkrim dhe do t'i jep një kopje të tij azilkërkuesit. Vendimi do t'i shpjegohet azilkërkuesit në një gjuhë të cilën ai ose ajo e kupton. Parashtruesit të kërkesës do t'i jepen 15 ditë për t'u ankuar ndaj vendimit refuzues.

Neni 28
Refuzimi në rastin e mashtrimit ose mungesës së besueshmërisë

28.1 Organi Kompetent do të marrë parasyh cilindo nga aktet e cekura më poshtë në këtë nen dhe do te kete te drejten e vendimit nëse duhet t'i jep mbrojtje ose jo. Sidoqoftë, prezenca e këtyre akteve mund të mos përdoret nga Organi Kompetent si bazë për të mohuar Mbrojtjen Plotësuese sipas neneve 2.7.1.i ose 2.7.1.ii.:

- (i) azilkërkuesi ka bazuar kërkesën e tij/ saj me identitet të rrejshëm ose dokumente të rrejshme, për të cilat ai ose ajo me vetëdije ka deklaruar gjatë intervistës të jenë origjinale;
- (ii) azilkërkuesi me vetëdije paraqet, me gojë apo me shkrim, një deklaratë të pavërtetë lidhur me arsyet për të cilat ai / ajo kërkon azilin;
- (iii) azilkërkuesi shkatërron ose në masë të madhe ndryshon me qëllim pasaportën e tij ose të saj ose cilindo dokument tjetër zyrtar i cili është i rëndësishëm për parashtrimin e kërkesës për azil dhe për përcaktimin e saktë të identitetit të tij nga Organi Kompetent, ose ka efektin e pengimit të rrjedhës së procedurës së azilit;

- (iv) azilkërkuesi me vetëdije fsheh se ai ose ajo ka dorëzuar një kërkesë të mëhershme për azil në cilindo shtet tjetër, posaçërisht kur behet fjale për përdorimin identiteti të rrejshëm;
- (v) azilkërkuesi keqpërdorë procedurën me qëllim të pengimit apo vonesës të depërtimit.

Neni 29

Zhvillimi i Procesit për Procedurën e Azilit

29.1 Dokumentet zyrtare, ftesat gjyqësore, vendimet dhe urdhëresat e nxjerra nga Organi Kompetent do t'i dorëzohen azilkërkuesit, përfaqësuesit të tij ose saj ligjor ose personit të autorizuar për të pranuar procesin nga azilkërkuesi. Dokumentet zyrtare do të konsiderohet se janë dorëzuar kur njëri nga personat e lartpërmendur ka njohur pranimin me anë të nënshkrimit. Si alternativë, deklarata me shkrim e betimit e personit që i dorëzon dokumentet do të vlerësohet si e mjaftueshme për të dëshmuar trajtimin e duhur ndaj dokumenteve zyrtare. Deklaratat e tilla, që verifikojnë pranim-dorëzimin duhet të jenë në përputhje me kushtet e parashtruara për pranim-dorëzimin e dokumenteve gjyqësore siç parashihet në ligjin lidhur me zhvillimin e procesit.

29.2 Faktet përkatëse të kërkesës për azil të paraqitura nga azilkërkuesi dhe të shënuara në shënimet e intervistuesit duhet t'i shpjegohen azilkërkuesit në gjuhën të cilën ai/ ajo e kupton para marrjes së vendimit nga Organi Kompetent dhe t'i lejohet azil kërkuarit të përmirësojë të gjitha gabimet e bëra gjatë regjistrimit të deklaratës së tij.

Neni 30

Ankesat kundër vendimit të shkallës së parë

30.1 Azilkërkuesi ka të drejtë të parashtoj ankesë kundër vendimit të Organit Kompetent dhe ta drejtojë atë te Komisioni.

30.2 Nëse vendimi është marrë në pajtim me nenin 27, ankesa mund të parashtrohet brenda 15 ditësh pas pranimit të vendimit. Nëse vendimi është marrë në pajtim me nenin 28 të këtij ligji, ankesa mund të parashtrohet brenda 7 ditësh pas pranimit të vendimit.

30.3 Azilkërkuesi, i cili për shkaqe të arsyeshme nuk mund të dorëzojë ankesën brenda afatit të paraparë, mund të lejohet të regjistrojë ankesën dhe të kërkojë rikthimin në gjendjen e mëparshme siç është parashtruar në këtë nen. Kërkesa për rikthim në gjendjen mëparshme duhet të dorëzohet brenda afatit prej 3 ditësh, pas ndërprerjes së shkakut të vonesës. Organi Kompetent do të vendos për kërkesën për rikthim në gjendjen e mëparshme brenda 3 ditësh nga dorëzimi i saj. Gjatë kësaj periudhe, urdhri për dëbimin dhe ose largimin e azilkërkuesit nga territori i Kosovës nuk mund të zbatohet.

30.4 Kundër vendimeve me të cilat Azilkërkuesi ose Azilanti do të dëbohen mund të parashtrohet ankesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 30 të këtij Ligji.

Neni 31

Komisioni Kombëtar për Refugjatë

31.1 Komisioni emërohet nga Qeveria e Kosovës sipas propozimit të Ministrisë të Punëve të Brendshme. Secili person i emëruar shërben në afat prej dy vitesh.

31.2 Komisioni përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe nëntë anëtarë të rregullt.

31.3 Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Komisionit emërohen nga radhët e juristëve të diplomuar, të punësuar në organet shtetërore administrative apo OJQ-të relevante dhe duhet të kenë së paku 5 vite përvojë pune profesionale.

31.4 Komisioni është i pavarur në punën e tij.

31.5 Komisioni vendos për rastet në këshilla prej tre anëtarësh. Këshilli merr vendimet me shumicë të votave.

31.6 Ministria do t'i sigurojë Komisionit hapësirë dhe mbështetje teknike për të kryer punët e tij.

31.7 Anëtarët e Komisionit emërohen në këtë përbërje:

- (i) përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- (ii) përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit;
- (iii) përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- (iv) përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- (v) përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë;
- (vi) përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- (vii) përfaqësuesi i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa;
- (viii) përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- (ix) përfaqësuesi i UNHCR-së dhe dy përfaqësues tjerë të caktuar nga OJQ-të të cilët merren me çështjet e refugjatëve dhe të drejtave dhe lirive të njeriut.

Neni 32

Procedura në shkallën e dytë

32.1 Komisioni vendos për ankesat duke u bazuar në dëshmi të mbledhura gjatë rrjedhës së procedurës së Azilit në shkallën e parë.

32.2 Nëse Komisioni vërteton se Organi Kompetent i shkallës së parë vendimin për mohimin e të drejtës për azil apo Mbrojtjen Plotësuese e ka marrë si pasojë e zbatimit të gabuar të ligjit, fakteve ose sipas procedurës të gabuar apo të paarsyeshme ose nëse ka pasur ndryshim të rrethanave të azilkërkesit, Komisioni ose do të anulojë vendimin dhe do ta kthejë atë për shqyrtim në shkallën e parë, do të ofroj procedurë shtesë ku Komisioni do të përmirësoj

mangësitë e përmendura dhe do të marrë vendimin e vet mbi dëshmitë e rishqyrtuara ose do ta ndryshoj vendimin e shkallës së parë duke marrë vendimin e tij mbi të njëjtat dëshmi.

32.3 Komisioni vendos për ankesën brenda 30 ditësh, pas parashtrimit të ankesës.

Neni 33

Parashtrimi i kërkesës së re për azil

Azilkërkuesi, kërkesa e të cilit është refuzuar në shkallë të parë dhe të dytë dhe në rast të shqyrtimit gjyqësor nga gjykata, mund vetëm të dorëzojë kërkesën për rishqyrtimin e rastit të tij nëse ai ose ajo paraqet dëshmi për ndryshimin e rrethanave që kanë shërbyer si bazë për vendimin e përparmë. Nëse faktet e parashtruara nga azilkërkuesi nuk e mbështesin ndryshimin e rrethanave, Organi Kompetent mund të refuzojë kërkesën pa filluar procedure të re.

Neni 34

Ndërprerja e procedurës për përcaktimin e Azilit

Vendosja e procedurës për azil mund të mbyllet para vendimit mbi pranueshmërinë e kërkesës për shkak të rrethanave të mëposhtme:

- (i) kur azilkërkuesi tërheq kërkesën e tij ose të saj për azil;
- (ii) kur azilkërkuesi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk i përgjigjet ftesës për intervistë nga Organi Kompetent;
- (iii) kur azilkërkuesi nuk informon me kohë DKAM lidhur me ndryshimin e adresës së tij ose të saj ose në çfarëdo mënyre e pengon zhvillimin e procesit;
- (iv) kur azilkërkuesi nuk bashkëpunon me organet shtetërore në zbulimin e identitetit të tij ose të saj;
- (v) kur azilkërkuesi refuzon të bashkëpunojë me zyrtarët në mbledhjen e të dhënave dhe të fakteve relevante për përcaktimin e kërkesës së tij ose të saj për azil;
- (vi) kur azilkërkuesi braktisë Kosovën gjatë procedurës pa pëlqimin e Organit Kompetent të shkallës së parë.
- (vii) parashtruesi i kërkesës mund të bëjë kërkesën pran Organit Kompetent për rihapje të procedurës së azilit dhe kjo mund të aprovohet nga Organi Kompetent nëse ka arsye të fortë. Kërkesa për rihapje të procedurës së azilit do të ndalojë dëbimin e të huajit nga Kosova deri në vendimin e kësaj anekese. Nuk lejohet anekesa kundër këtij vendimi.

Neni 35

Dëbimi i dhunshëm

35.1 Azilkërkuesi, kërkesa e të cilit për azil ose Mbrojtje Plotësuese është refuzuar, dhe i cili nuk e lëshon territorin e Kosovës në afatin e paraparë, do t'i nënshtrohet ligjeve të imigracionit dhe mund të dëbohet dhunshëm nga territori i shtetit.

35.2 Dëbimi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni nuk do të zbatohet para përfundimit të procedurës së azilit, e cila kërkon një vendim përfundimtar. Procedura e azilit do të konsiderohet e papërfunduar nëse është bërë kërkesa përkatëse në gjykatën kompetente në Kosovë për të shqyrtuar vendimin dhe i cili është në pritje. Procedura konsiderohet e përfunduar nëse:

- (i) afati për ankesë kundër vendimit të shkallës së parë ka kaluar dhe ankesa nuk është dorëzuar. Nëse ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit, por nuk është pranuar rikthimi në gjendjen e mëparshme;
- (ii) vendimi i Gjykatës Supreme është dhënë, me të cilin kërkesa është refuzuar.

KREU III

Neni 36

Të Drejtat dhe Detyrimet e Azilkërkuesit

36.1 Azil-kërkuesi ka të drejtë:

- (i) të banoj në Republikën e Kosovës në pritje të kompletimit të procedurave për përcaktimin e azilit;
- (ii) të ketë kushtet themelore të jetesës;
- (iii) kujdesin themelor shëndetësor;
- (iv) ndihmën sociale themelore;
- (v) ndihmën ligjore pa pagesë;
- (vi) ndihmën humanitare;
- (vii) të drejtën e arsimimit dhe
- (viii) të drejtën e punësimit.

36.2 Ministria do të nxjerrë akte nënligjore përkitazi me zbatimin e të drejtave nga paragrafi 1 i këtij neni, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

Neni 37
E drejta e azilkërkuesit për qëndrim të përkohshëm

37.1 Azilkërkuesi, i cili ka hyrë në Kosovë në pajtim me nenin 8 të këtij ligji, dhe i cili ka parashtruar kërkesë për azil, i lejohet qëndrimi në Republikën e Kosovës për një periudhë kohore deri në marrjen e vendimit përfundimtar për rastin e tij/saj.

37.2 Qëndrimi i Përkohshëm, siç parashihet paragrafin 1 të këtij neni, po ashtu do të ofrohet për të huajin në Republikën e Kosovës pa status ligjor dhe i cili ka paraqitur kërkesën për azil.

Neni 38
Akomodimi në Qendrën e Azilit

38.1 Ministria krijon dhe menaxhon objekte të duhura për azil. Këto objekte mund të shfrytëzohen nga Ministria për të vendosur azilkërkuesit të cilët kanë bërë kërkesë për azil dhe presin vendimin për kërkesën e tyre.

38.2 Në Objektet e azilit mund të vendosen azilkërkuesit në pajtim me nenin 36 të këtij ligji.

38.3 Nëse azilkërkuesit kanë kërkesat themelore materiale për veten e tyre ose nëse vendosja dhe ndihma sociale i sigurohet atij / asaj në një mënyrë tjetër, Organi Kompetent mund të urdhërojë që azilkërkuesi të qëndrojë jashtë objekteve të azilit. Organi Kompetent mund të urdhërojë ndalesa të arsyeshme të lirisë së lëvizjes, në pajtim me këtë ligj.

38.4 Të miturve, femrave dhe azilkërkuesve me nevoja të veçanta do t'iu sigurohen ndihme dhe përkrahje në varësi nga nevojat e tyre.

Neni 39
Detyrimet e azilkërkuesit

Azilkërkuesi është i detyruar që:

- (i) gjatë gjithë kohës të veproj në pajtim me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të Republikës së Kosovës, si dhe me masat e ndërmarra nga organet shtetërore;
- (ii) të bashkëpunojë me DKAM-në dhe organet e tjera relevante qeveritare;
- (iii) t'i përgjigjet ftesave të Organit Kompetent dhe zyrave të tjera qeveritare dhe të bashkëpunojë në çdo fazë të procedurës së azilit;
- (iv) të njoftojë DKAM-në dhe organet e tjera përkatëse të azilit për çfarëdo ndryshimi të adresës brenda 7 ditësh;
- (v) të veprojë në pajtim me urdhrat që lëshohen nga Organi Kompetent, DKAM-ja si dhe të gjitha urdhrat e tjera qeveritare lidhur me kufizimet e lëvizjes.
- (vi) të mos lëshojë territorin e Kosovës pa lejen e Organit Kompetent derisa të mos përfundohet procedura e azilit.

KREU IV

Neni 40

Të drejtat e Azilantit ose të të Huajit të cilit i është dhënë Mbrojtja Plotësuese

40.1 Kur është dhënë azili apo mbrojtja plotësuese, azilanti ose i huaji të cilit i është njohur azili ose Mbrojtja Plotësuese, i ka të drejtat e mëposhtme:

- (i) vendqëndrimin në Republikën e Kosovës për kohën sa zgjat Azili ose Mbrojtja Plotësuese;
- (ii) ndihmën sociale elementare;
- (iii) strehimin elementar;
- (iv) kujdesin shëndetësor elementar;
- (v) arsimimin;
- (vi) ndihmesën për integrim në shoqëri;
- (vii) të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar;
- (viii) të drejtën për punësim duke përfshirë edhe vetëpunësimin;
- (ix) bashkimin me familjen e ngushtë, siç përkufizohet në nenin 3 të këtij ligji;
- (x) të drejtën në qasje në gjykata dhe ndihmë ligjore.
- (xi) të drejtën në lirinë e lëvizjes brenda Kosovës;
- (xii) të drejtën për të poseduar pasuri të tundshme dhe të patundshme;
- (xiii) të drejtën për të mbrojtur pronën e tyre intelektuale dhe
- (xiv) të drejtën e anëtarësimit në shoqata.

40.2 Azilanti dhe i huaji të cilit i është dhënë Mbrojtja Plotësuese, gëzojnë të drejtat nga paragrafi 1 i këtij neni deri në nivelin e mbrojtjes të cilën e gëzojnë shtetasit e Republikës së Kosovës.

40.3 Ministria, në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit dhe me Ministrinë kompetente nxjerr akte nënligjore lidhur me të drejtat nga neni 40.1 i këtij Ligji.

Neni 41

Leja për qëndrim të përhershëm

41.1 Vendimi përfundimtar, me të cilin i është lejuar Azili, Mbrojtja Plotësuese të huajit, po ashtu është dëshmi vlefshme e së drejtës së qëndrimit të përhershëm në shtetin e Republikës së Kosovës gjatë kohëzgjatjes së statusit të tyre të Azilit ose Mbrojtjes Plotësuese.

Neni 42
E drejta në ndihmën sociale

42.1 Azilanti ose i huaji, të cilit i është dhënë Mbrojtja Plotësuese dhe i cili nuk ka të ardhura, pasuri dhe nuk merr ndihmë nga personat e tjerë të cilët janë të detyruar ose janë në gjendje për ta ndihmuar atë, kanë të drejtën në ndihmën sociale në pajtim me legjislacionin e Republikës së Kosovës në fuqi.

42.2 Azilanti ose i huaji të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese dhe i cili në mënyrë të paarsyeshme refuzon të punësohet në punën e ofruar ose refuzon të hyjë në format e tjera të punësimit aktiv, vlerësohet se ka humb të drejtën e tij ose të saj për ndihmë sociale.

Neni 43
Sigurimi i strehimit elementar

43.1 Strehimi elementar i sigurohet azilantit dhe të huajit të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese.

43.2 Nëse azilanti ose i huaji, të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese, në mënyrë të paarsyeshme refuzon ofrimin e strehimit elementar të caktuar në paragrafin 1 të këtij neni, , ai / ajo vlerësohet se ka humbur të drejtën për të marrë ndihmën për strehim.

Neni 44
E drejta për kujdesin shëndetësor

44.1 Azilanti dhe i huaji, të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese, kanë të drejtën për kujdesin shëndetësor në nivel të njëjtë sikur edhe shtetasit e Kosovës.

Neni 45
Arsimimi

45.1 Azilantit dhe të huajit, të cilit i është lejuar Mbrojtjes Plotësuese, do t'iu sigurohet trajtim i barabartë me shtetasit e Republikës së Kosovës lidhur me të drejtën për arsimimin fillor, të mesëm dhe atë dhe të lartë.

Neni 46
Ndihma për t'u integruar në Republikën e Kosovës

46.1 Ministria do të themelojë shërbimet për azilantë dhe të huajt të cilëve iu është lejuar Mbrojtja Plotësuese me qëllim të nxitjes së integritimit të këtyre personave në jetën ekonomike,

sociale dhe kulturore të shtetit. Për të arritur qëllimet e këtylla, kujdes i veçantë do t'i kushtohet:

- (i) sigurimit të kurseve për t'i mundësuar azilantëve dhe të huajve të cilëve ju është dhënë Mbrojtja Plotësuese të mësojnë së paku njërën prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës;
- (ii) organizimit të kurseve dhe formave të tjera të arsimit dhe trajnimit profesional;
- (iii) informimit për historinë, kulturën dhe dispozitat kushtetutës të Republikës së Kosovës.

Neni 47 Punësimi

Azilanti dhe i huaji, të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese, kanë të drejtën për punësim në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 48 Ofrimi i ndihmës juridike

Azilantit dhe të huajit, të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese, do t'i ofrohet ndihmë juridike, identike me atë sikur shtetasve të Republikës së Kosovës.

Neni 49 Detyrimet e Azilantit dhe të Huajit, të cilit i është dhënë Qëndrimi i Kushtëzuar

49.1 Azilanti dhe i Huaji, të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese, janë të detyruar:

- (i) të veprojnë në pajtim me rendin kushtetues, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në Republikën e Kosovës;
- (ii) të njoftojnë Organin Kompetent brenda 7 ditësh lidhur me vendin e tij ose të saj të banimit si dhe për çdo ndryshim të adresës;
- (iii) të njoftojnë Organin Kompetent për punësimin në të cilin ai ose ajo janë të angazhuar.

KREU V

Neni 50 Lëshimi i dokumenteve

50.1 Ministria i lëshon azilkërkuesve dokumentet e mëposhtme brenda 7 ditëve pas pranimit të aplikacionit për Azil:

- (i) vërtetimin për dorëzimin e kërkesës për azil;

(ii) letërnjoftimin për azilkërkuesin.

50.2 Azilantit dhe të huajit, të cilit i është lejuar Mbrojtja e Kushtëzuar, do t'u lëshohen dokumentet si në vijim:

(i) letërnjoftimi; dhe

(ii) dokumenti i udhëtimit.

50.3 Dokumentet e përcaktuara në paragrafin 1, nën paragrafët (i), (ii) dhe paragrafin 2, nën paragrafët (i) dhe (ii) të këtij neni lëshohen nga Ministria në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 51

Letërnjoftimi i azilkërkuesit

51.1 Letërnjoftimi i azilkërkuesit shërben po ashtu si leje e përkohshme për qëndrim në Republikën e Kosovës.

51.2 Letërnjoftimi ju lëshohet të gjithë anëtarëve të varur të familjes të azilkërkuesit.

51.3 Letërnjoftimi i azilkërkuesit është i vlefshëm deri në përfundimin e procedurës së azilit.

Neni 52

Letërnjoftimi i azilantit dhe e të huajit që i është dhënë Mbrojtja Plotësuese

Secilit azilant dhe i huaj, të cilit i është njohur Mbrojtja Plotësuese do t'i lëshohet Letërnjoftimi. Këtu përfshihen azilantët të cilëve ju është dhënë mbrojtje në bazë të prejardhjes dhe përfituesit e ribashkimit të familjes në rast se të huajit i është dhënë Mbrojtja Plotësuese.

Neni 53

Dokumentet e udhëtimit për azilantë dhe të huajt, të cilëve iu është dhënë Mbrojtja Plotësuese

53.1 Pas parashtrimit të kërkesës në DKAM, azilantit ose të huajit të cilit i është dhënë Mbrojtja Plotësuese, do t'i lëshohet dokumenti i udhëtimit.

53.2 Kërkesa për dokumentet e udhëtimit duhet të parashtrohet personalisht nga azilanti apo i huaji të cilit i është dhënë Mbrojtja Plotësuese, nëse ai ose ajo është në moshën 18 vjeçare dhe ka zotësinë e veprimit apo përmes përfaqësuesit të tij/saj ligjor.

53.3 Kur azilanti ose i huaji, të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese është më i ri se 18 vjet, kërkesa duhet të dorëzohet nga përfaqësuesi ligjor i tij/saj ose kujdestari.

53.4 Organi Kompetent do të konfirmojë statusin e azilit për qëllimet e përfshira në këtë nen.

53.5 Kohëzgjatja e dokumentit të udhëtimit të refugjatit për azilantin dhe të huajin, të cilit i është lejuar Mbrojtja Plotësuese, varen nga mosha e personit, siç parashihet me sa vijon:

- (i) fëmijës deri në moshën 3 vjeçare do t'i jepet dokumenti i udhëtimit i cili është i vlefshëm për 3 vite;
- (ii) fëmijës prej moshës 3 deri 18 vjeç do t'i jepet dokumenti i udhëtimit i vlefshëm për 5 vite;
- (iii) personit i cili është në moshën 18 vjeçare ose më i vjetër do t'i jepet dokumenti i udhëtimit i vlefshëm për 10 vite.

53.6 Në rast të përfundimit të statusit të azilit ose të Mbrojtjes Plotësuese, siç parashihet me nenin 6 të këtij ligji, nga i huaji do të kërkohet t'ia kthejë dokumentin e udhëtimit Organit Kompetent.

KREU VI

Neni 54 Mbrojtja e përkohshme

54.1 Mbrojtja e përkohshme i lejohet të huajve që vijnë në Kosovë nga lëvizje të mëdha të popullsisë, kur ata:

- (i) kanë ikur si pasojë e efekteve pa dallim të konfliktit të armatosur dhe dhuna e përgjithësuar;
- (ii) janë në një situatë në të cilën jeta e tyre, integriteti personal ose liria e të cilëve është në rrezik si rezultat i shkeljes së gjerë të të drejtave të njeriut;
- (iii) kane ikur nga zonat e konfliktit të armatosur ose dhuna endemike;
- (iv) janë në rrezik serioz, ose kane qene viktime te shkeljeve sistematike ose te përgjithshme te te drejtave njerëzore, kurse vendi i origjinës nuk është në gjendje t'i mbrojë.

54.2 Për të huajt nga paragrafi 54.1 i këtij ligji, të cilët janë shtetas të vendit prej të cilit kanë ikur ose janë pa shtetësi, do të ju sigurohet Mbrojtja e Përkohshme në Republikën e Kosovës nëse:

- (i) para ndodhjes së gjendjes të cekur në 54.1 të këtij ligji i huaji ka jetuar në atë shtet dhe për shkak të situatës ka ardhur në Republikën e Kosovës;
- (ii) ose, i huaji ka hyrë në mënyrë ligjore në Republikën e Kosovës, por me skadimin e statusit të tij/saj, ai ose ajo nuk kanë qenë në gjendje të kthehen në shtetin e origjinës ose vendqëndrimit të tyre për arsye të cekura në nenin 54.1 të këtij ligji.

54.3 Ministria, në konsultim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, do të zhvillojë një vlerësim të situatës në vendin e prejardhjes kur përballen me situatën e valëve masive të individëve që duket se plotësojnë përkufizimin e parashtruar në nenin 54.1 të këtij Ligji që të përcaktojnë nëse trajtimi i mbrojtjes së përkohshme duhet të zgjerohet për kategori të veçantë të individëve nga ai vend.

Neni 55
Dhënia e Mbrojtjes së Përkohshme dhe kohëzgjatja e saj

55.1 Mbrojtja e përkohshme për të huajt lejohet nga Ministria me një kohëzgjatje prej 6 muajsh në pajtim me nenin 54 të këtij ligji.

55.2 Mbrojtja e Përkohshme mund të vazhdohet për gjashtë muaj shtesë nëse vazhdojnë kushtet në vendin e prejardhjes së personit të mbrojtur të cilat përbënin bazë të vendimit për dhënien e Mbrojtjes së Përkohshme . Mbrojtja e Përkohshme mund të zgjatet për një periudhë maksimale prej 2 vitesh.

Neni 56
Shkaqet e ndërprerjes së Mbrojtjes së Përkohshme

56.1 Ministria mund të ndërpres Mbrojtjen e Përkohshme nëse:

- (i) situata në vendin e prejardhjes ka ndryshuar rrënjësisht dhe e lejon kthimin e qëndrueshëm të përfituesve në vendet e tyre të origjinës në kushte sigurie dhe të respektimit të duhur të dinjitetit të tyre;
- (ii) paraqitet se i huaji mund të mos e ketë të drejtën në azil për shkak të arsyeve të parashtruara në nenin 5 të këtij ligji;
- (iii) paraqitet se i huaji me status të Mbrojtjes së Përkohshme mund të jetë rrezik për sigurinë e vendit ose, pasi është dënuar me vendim të prerë për krim posaçërisht të rëndë, mund të paraqesë rrezik për komunitetin;
- (iv) kërkesa e tij / saj për azil është dhënë ose një status tjetër më me përparësi i është dhënë të huajit në pajtim me legjislacionin e Republikës së Kosovës;
- (v) ai/ajo gëzon mbrojtjen ndërkombëtare alternative ose e ka të rregulluar shtetësinë ose qëndrimin në një vend tjetër.

Neni 57
Ndërprerja e Mbrojtjes së Përkohshme

57.1 Mbrojtja e Përkohshme mund të përfundojë për të huajin:

- (i) me kalimin e afatit të lejuar;
- (ii) me urdhrin e Ministrisë lëshuar ndaj të huajit;
- (iii) kur ai / ajo vullnetarisht e lëshon Kosovën.

57.2 Pas ndërprerjes së mbrojtjes së përkohshme si është paraparë me këtë Ligj, i huaji ka të drejtë të bëjë kërkesë për azil në pajtim me nenin 4 dhe 62 të këtij Ligji.

Neni 58

Të drejtat dhe detyrimet e të huajve të cilëve i'u është lejuar Mbrojtja e Përkohshme

58.1 I huaji, të cilit i është lejuar Mbrojtja e Përkohshme, ka të drejtë:

- (i) të qëndrojë përkohësisht në Republikën e Kosovës në pajtim me nenin 54 të këtij ligji;
- (ii) të kushtet themelore për strehim dhe jetesë;
- (iii) të mbrojtjen shëndetësore, arsimimin fillor dhe të mesëm me kushte të njëjta me ato të shtetasve të Republikës së Kosovës;
- (iv) të qasje për këshillim dhe mbrojtje juridike;
- (v) në lirinë e besimit fetar;
- (vi) lirinë për t'u angazhuar në aktivitete të punësimit dhe të vetëpunësimit;
- (vii) në ndihmën e domosdoshme, në kuptimin e mirëqenies sociale.

58.2 Detyrat e përcaktuara në nenin 49 të këtij ligji vlejné poashtu për të huajt, të cilëve iu është dhënë Mbrojtja e Përkohshme.

Neni 59

E drejta mbi bashkimin familjar

59.1 Ribashkimi familjar me anëtarët e varur të familjes lejohet për personat të cilëve iu është dhënë Mbrojtja e Përkohshme për anëtarët e familjes, siç është përkufizuar në nenin 3 të këtij ligji.

59.2 Anëtarëve të familjes, të cilët janë ribashkuar sipas nenit 59.1 të këtij Ligji, do t'iu jepet Mbrojtja e Përkohshme.

Neni 60

Akomodimi i të huajve të cilëve iu është lejuar Mbrojtja e Përkohshme

Të huajve, të cilëve i'u është lejuar Mbrojtja e Përkohshme, do t'iu sigurohet akomodimi në pajtim me mundësitë ekonomike të Republikës së Kosovës.

Neni 61

Letërnjoftimi për të huajt, të cilëve iu është lejuar Mbrojtja e Përkohshme

Ministria lëshon Letërnjoftimin për të huajt, të cilëve iu është dhënë Mbrojtja e Përkohshme.

Neni 62
Mundësia për të kërkuar Azil

62.1 I huaji të cilit i është dhënë Mbrojtja e Përkohshme në pajtim me këtë ligj, mund të parashtroje kërkesën për azil gjatë ose pas kalimit të afatit të Mbrojtjes së Përkohshme.

62.2 Kërkesa për azil, e cila është parashtruar para kalimit të afatit të statusit të Mbrojtjes së Përkohshme, do të shqyrtohet pas skadimit të Mbrojtjes së Përkohshme. Pas skadimit të Mbrojtjes së Përkohshme dhe derisa vendimi përfundimtar për azilin nuk është marrë, i huaji nuk duhet të dëbohet nga Republika e Kosovës dhe duhet të trajtohet në pajtim me dispozitat e parashtruara për azilkërkuesit me këtë ligj.

KREU VII

Neni 63
Llojet e të dhënave që duhet të mblidhen

Me qëllim të sigurimit të informacionit të kërkuar për ushtrimin e detyrave të parapara me këtë ligj, mblidhen dhe mirëmbahen të dhënat e mëposhtme në bazën e të dhënave:

- (i) kërkesa e parashtruar për azil;
- (ii) azilkërkuesit nën moshën 18 vjeçare, të cilët nuk janë të përcjellur nga prindërit;
- (iii) azilkërkuesit e vendosur në objektet e azilit;
- (iv) azilkërkuesit e vendosur jashtë objekteve të azilit;
- (v) personat, të cilëve u është njohur azili në pajtim me nenin 4 të këtij ligji;
- (vi) personat, të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil;
- (vii) personat, të cilëve procedura e azilit u është ndërprerë;
- (viii) personave të cilët kanë dorëzuar kërkesa të përsëritura për azil;
- (ix) letërnjoftimin e lëshuar për azilkërkuesit;
- (x) letërnjoftimin e lëshuar për personat, të cilëve është njohur Azili ose Mbrojtja Plotësuese;
- (xi) dokumentet e udhëtimit të lëshuara për personat, të cilëve është njohur Azili ose Mbrojtja Plotësuese;
- (xii) letërnjoftimin e lëshuar për të huajt nën Mbrojtje të Përkohshme.

Neni 64
Të dhënat e kërkuara nga azilkërkuesit si dhe nga ata që kërkojnë forma tjera të mbrojtjes

64.1 Kërkesa për azil si dhe kërkesat për forma tjera të mbrojtjes të parapara në këtë ligj do të përcaktohen në një formë për të cilën do të vendos Ministria në pajtim me nenin 16 të këtij ligji.

64.2 Azilkërkuesi ka për detyrë që t'i japë Organit Kompetent të dhënat si vijon:

- (i) emrin dhe mbiemrin, datëlindjen dhe vendlindjen;
- (ii) emrat e prindërve;
- (iii) gjininë;
- (iv) statusin martesor;
- (v) shtetësinë, nacionalitetin, religjionin;
- (vi) gjuhën amtare dhe njohjen e gjuhëve të tjera;
- (vii) adresën e fundit të banimit;
- (viii) datën e lëshimit të shtetit të origjinës;
- (ix) shtetet në të cilat ai se ajo kanë qëndruar;
- (x) datën e plotë, vendin dhe mënyrën se si ka hyrë në Kosovë;
- (xi) dokumentin e identifikimit, llojin, numrin, datën dhe vendin e lëshimit;
- (xii) arsimimin dhe profesionin;
- (xiii) anëtarësinë në ndonjë parti politike ose organizatë;
- (xiv) kërkesat e mëhershme për azil në Republikën e Kosovës ose në cilindo shtet tjetër;
- (xv) hollësitë për familjen e të miturit të pashoqëruar;
- (xvi) anëtarët e ngushtë të familjes që e shoqërojnë azilkërkuesin;
- (xvii) të afërmit e tjerë që e shoqërojnë azil-kërkuesin;
- (xviii) të afërmit e tjerë që qëndrojnë në Republikën e Kosovës;
- (xix) anëtarët e familjes së ngushtë që banojnë në shtetin e prejardhjes;
- (xx) anëtarët e familjes së ngushtë që jetojnë jashtë shtetit të prejardhjes;
- (xxi) dëshmitë dhe deklaratimet e azilkërkuesit;
- (xxii) kërkesat e tjera, nëse kërkohen nga zyrtari kompetent.

64.3 Azilkërkuesi duhet të jep pëlqimin me shkrim, i cili i jep Ministrisë lejen për të përpunuar kërkesën e parashtruar dhe të dhënat e përmbajtura në të. Para plotësimit të kërkesës së parashtruar, azilkërkuesi duhet të njoftohet me gojë dhe me shkrim lidhur me arsyet për mbledhjen e këtyre të dhënave, periudhën e kohës në të cilën këto të dhëna do të ruhen dhe mënyrën se si do të përdoren.

Neni 65
Arkivat dhe mbrojtja e të dhënave personale

65.1 Të dhënat personale të mbledhura në pajtim me nenin 64.2 të këtij ligji do të ruhen nga Organi Kompetent. Tridhjetë vite pas kompletimit të procedurës, të dhënat do të vendosen në arkiva në pajtim me legjislacionin në fuqi.

KREU VIII

Neni 66
Mbledhja, përpunimi dhe komunikimi i të dhënave

66.1 Organi Kompetent si dhe agjencitë e tjera qeveritare të ngarkuara me mbledhjen dhe ruajtjen e shënimeve janë të autorizuar të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre lidhur me mbledhjen e të dhënave të azilkërkuesve dhe personave të tjerë që kanë parashtruar kërkesën për mbrojtje ose marrin mbrojtjen e paraparë sipas këtij ligji.

66.2 Të dhënat e cekura në nenin 66.1 të këtij Ligji do të përpunohen në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të Dhënave Personale.

66.3 Të dhënat e mbledhura përmes gjurmës së gishtave dhe fotos së azilkërkuesit do të përdoren për shqyrtimin e rastit të tij / saj të azilit ose mbrojtjen tjetër të parashikuar me këtë ligj si dhe për procedurat e ndërlydhura të migracionit.

Neni 67
Komunikimi i të dhënave shtetit të origjinës

67.1 Të dhënat e mbledhur për një person në pajtim me nenin 66 të këtij ligji nuk i komunikohen shtetit të prejardhjes përveç siç është paraparë me nenin 67.2 të këtij Ligji.

67.2 Në rast të personit, kërkesa e të cilit për azil dhe forma të tjera të mbrojtjes është refuzuar dhe për të cilin është lëshuar një urdhër i depërtimit, të dhënat e mëposhtme mund t'i jepen shtetit të prejardhjes:

- (i) emri, mbiemri dhe data e lindjes;
- (ii) gjinia dhe nacionaliteti;
- (iii) të dhënat për anëtarët e familjes kur është e nevojshme për të përcaktuar identitetin personal dhe shtetësinë;
- (iv) të dhënat nga dokumentet e lëshuara nga shteti i prejardhjes për të vërtetuar identitetin personal dhe shtetësinë;
- (v) shenjat e gishtërinjve dhe fotografitë, nëse vlerësohet si e domosdoshme.

KREU IX

Neni 68

Kërkesat e parashtruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji

Kërkesat për azil, të cilat i janë parashtruar UNHCR-së, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas këtij ligji

Neni 69

Themelimi i Objekteve të Azilit

Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, do të krijohet objekti i azilit.

Neni 70

Mënyra e rregullimit të lejeve, dokumenteve dhe dëshmime

Ministria do të nxjerrë akte nënligjore në pajtim me nenin 50 dhe nenin 63 të këtij ligji.

Neni 71

Dokumentet e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji

Organi Kompetent siguron vazhdimësinë e statusit të Refugjatëve në Kosovë të njohur nga UNHCR-ja dhe u lëshon dokumente atyre në pajtim me këtë ligj. Sipas nevojës, UNHCR dhe Organi Kompetent do të shkëmbejnë informata lidhur me këto raste.

Neni 72

Zbatim i ligjit

72.1 Me shpalljen e këtij ligji, shfuqizohen dispozitat e neneve 12 deri 21 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/16 mbi Lëvizjen e Personave Brenda dhe Jashtë Republikë së Kosovës.

Neni 73

Hyrja në fuqi

73.1 Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë (15) pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

73.2 Procedurat e filluara në pajtim me nenet 12 deri 21 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/16 mbi Lëvizjen e Personave Brenda dhe Jashtë Kosovës do të përfundojnë në pajtim me të njejtën procedurë kurdo që është e mundshme.

Ligji Nr. 03/L-066
21 maj 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI